



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/ Nr. 5207 /2019

Data: 10.06.2019

### PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e pestë - V- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 31.05.2019 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Edon Curri (Drejtor për Administratë), Bashkim Sopa (Zyrtar për Informim), Bajrush Laçi (Shef i Zyrës Ligjore), Betime Bushi (Praktikante në Komunë), Përfaqësuesit e OSB-së. Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnje anëtarë i kuvendit të komunës.

#### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Miratimi i rishikimit të buxhetit të komunës për vitin 2019.
3. Shqyrtimi i plotësim ndryshimit të rregullores për transparencë.
4. Miratimi i propozim vendimit për themelimi e vend gjuetisë së përbashkët në territorin e komunës së Hanit të Elezit.
5. Informatë mbi mbrojtjen e mjedisit.
6. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- pikën e dytë të rendit të punës rishikimin e buxhetit të komunës për vitin 2019 e kemi proceduar se nëse qeveria kërkon me u bërë rishikimi i buxhetit të komunës me pasur të gatshme. Në këtë muaj nuk është bërë dhe e procedojmë për në muajin tjetër. Ndërkohë është dërguar edhe një material shtesë për shkak se është dashur me kaluar nëpër disa procedura sepse për nderë të Ditës së Dëshmorëve lapidari duhet të jetë i gatshëm. Lënda nuk ka mundur me u proceduar për shkak se prona nuk ka qenë në emër të vëllait të Gafurr Luku dhe Drejtoria e Urbanizmit i ka kryer procedurat dhe propozoj të hynë në rend të punës. Lidhur me rendin e punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:- për pikën e dytë të rendit të punës diskutuan edhe në KPF dhe jam dakord që të hiqet prej rendit të punës, kurse pika e tretë e rendit të punës kërkoj që mos të procedohet por të kthehet dhe të përpunohet edhe një herë. Për materialin shtesë edhe më herët kemi diskutuar që mos me pasur pika shtesë me vonesë për shkak se edhe ne i kemi obligimet tona, mirëpo arsyetë madhe nuk keni pasur për me proceduar sepse e keni ditur se në plan të kryetarit të komunës e keni pasur këtë projekt.

Kryesuesi thekson:- në KPF e ke diskutuar dhe arsyetë ishte se ka pasur gabime teknike dhe nenet në të cilat nuk jeni pajtuar besoj që janë përmirësuar. Proceduraishtë nga kuvendi votohet për në debat publik dhe pas debatit publik kthehet për miratim në kuvendin e komunës.

Mefail Suma thekson:- në mbledhjen e fundit kam parashtruar kërkesë për këtë mbledhje të diskutohet si pikë e rendit të punës nepotizmi familjarë dhe politik në komunë. Me lobuar nuk kam lobuar por kërkoj edhe nga grupet tjera parlamentare që të përkrahet kjo pikë e rendit të punës. Kërkoj që të diskutohet si pikë e veçantë.

**Kryesuesi thekson:-** mund të diskutoni edhe te të ndryshe por unë si kryesues i kuvendit nuk e kam paraparë atë pikë dhe nëse kërkon mund ta procedojmë në votim.

**Nuriman Kuka thekson:-** edhe unë jam i mendimit që të shtohet kjo pikë e rendit të punës por në këtë mbledhje jo por nëse jeni në dakord për mbledhje të ardhshme.

**Florim Shkreta thekson:-** vërejtje kam për caktimin e ditës së mbajtjes së seancës së kuvendit të komunës dhe kjo nuk është në rregull sepse është dashur të njoftohen këshilltarët e kuvendit të komunës. Nuk e di arsyen se pse e keni caktuar në këtë ditë kur e dini se sot është dita e premte. Edhe unë jam i mendimit që kjo pikë me u diskutuar sot por sa i përket asaj që potencove përmes votave mendoj që nuk mundemi me arritur.

**Kryesuesi thekson:-** çdo ditë pune kam të drejtë me mbajtur kuvendin e komunës por kjo është bërë me mirëkuptim te arsimi në mënyrë që mos me humbur orë e kam përcaktuar ditën e ejte për ndryshe obligim nuk e kam dhe nga dita e hënë deri të premtën mundem në cilën do ditë me caktuar.

**Akif Shkreta thekson:-** unë nuk jam që mos të diskutohet çdo gjë por sa kemi të drejtë të diskutojmë për çështje të tilla kur janë të rregulluara me ligj, mirëpo ne mund ta diskutojmë ndonjë çështje në çoftë se në komunë ka pasur shkelje të procedurave gjatë pranimit të një punëtori në punë dhe ato shkelje mundemi me denoncuar në gjykatë. Çështja e punësimit është e rregulluar me ligj dhe nëse ka shkelje procedurale janë organet e tjera. Ne jemi qytetarë të Hanit të Elezit dhe me secilin person jemi të afërt pavarësisht a jemi pozitë apo opozitë dhe nëse bëhet ndonjë statistikë del që të gjithë jemi pjesë e komunës.

**Mefail Suma thekson:-** në ligj nuk shënon se çka mund të flas njeriu dhe çka nuk mund të flasë në asamble komunale për atë jemi të votuar dhe të ftuar këtu. Unë e di që është jo i mirëseardhur ky propozim dhe nëse nuk kalon këtu edhe në mbledhjen e kaluar edhe sot shefi i grupit parlamentarë i LDK-së potencoi që me lënë në mbledhjen e radhës unë te pika e rendit të ndryshme do ta paraqesë.

**Florim Shkreta thekson:-** nuk e di ku është duke jetuar parafolësi z. Akif Shkreta i cili potencon se mund të ankoheni në gjykatë nëse ka shkelje, mirëpo shkelje ka sa të duash dhe në çdo konkurs po dihet se kush do të pranohet kurse gjurmët po i mbulojnë dhe nuk është mirë për shkak se ne po e dimë se çka ka ndodhë sepse ne e dimë që kryetari një rrëth që e ka mund ta punëson por është tepruar kjo çështje. Po ikin personat që duhet me kontribuar në Han të Elezit.

**Kryesuesi thekson:-** për nepotizmin secili e ka mendimin e vetë por edhe unë kisha diskutuar për nepotizmin kur nuk isha në pushtet në vitin 2000-2009 si jurist i diplomuar kam punuar me dokumente si shpediter dhe secili e kupton në mënyrën e vetë. z.Mefail Suma e kuptojë por edhe ai e dinë nepotizmin e vetë të cilit me dokumentacion i kanë shkuar në terminal dhe unë jam paraqitur me kërkuar punë por nuk kam mundur me ardhur në rend sepse nuk isha në vijën e atyre që e kanë pasur pushtetin. Nepotizmi është një temë e gjerë që donë elaborim të madh. Unë jam që të diskutohet por të diskutohet prej vitit 1999 në mënyrë që të shihet nepotizmi për secilin në periudhën e vetë që ka kaluar për shkak se dikush është duke hekur sot por dikush ka hekur edhe më herët. Jurist i diplomuar në vitin 2004 në terminal ka ardhur prej komunës së Ferizajit, kurse unë isha i diplomuar por kam bartur letra dhe nuk kam ardhur në rend për me u punësuar. Në asamble komunale kam ardhur për shkak se nuk kam mundur me u punësuar sepse po të kisha mundësi me u punësuar ne profesionin tim nuk do të konkurroja në asamble komunale.

**Mehmet Ballazhi thekson:-** kryesues po më vjen keç që po bien në këtë nivel të debatit për shkak se nuk ka nevojë me ra në këtë nivel sepse nëse ka kërkuar një pikë të renit të punës me shtuar ka të drejtë dhe mos potenconi sikur nënkyetari i komunës i cili në mbledhje të KPF potencojo që nuk ke të drejtë me diskutuar, mirëpo ju e shëndrruat në debat dhe ra në nivel që unë si anëtarë i kuvendit të kisha këshilluar mos me ra sepse je kryesues i kuvendit të komunës. Anëtarë i kuvendit ka kërkuar një pikë të renit të punës ju mund ta procedoni në votim dhe çështja e lobimit është e tij e jo me ra në këtë nivel sepse doli personale. Secili i ka vërejtjet dhe shqetësimet e veta papunësinë dhe ka lloj lloj çështje dhe ndoshta nepotizmi si çështje doket e vogël por nëse hyjmë ashtu jo vetëm në vitin 1999 por duhet të diskutohet edhe për vitet 1989, 1987 dhe 1985.

**Kryesuesi thekson:-** personal kam diskutime më të gjatë sepse 20 vite kam konkurruar dhe nuk kam mundur me u punësuar dhe nëse diskutohet si nepotizmin jo vetëm prej një pushteti që ka kaluar dhe do të përgatitem që prej vitit 1999 me diskutuar.

**Nuriman Kuka thekson:-** unë në mënyrë të sinqertë po kërkojë që të diskutojmë në mbledhje të radhës dhe mos të hyjmë në debate të thella. Unë kërkojë mirëkuptim prej z.Mefail Suma dhe kryesuesit të kuvendit të komunës që në këtë mbledhje mos hyjë kjo pikë në rendin e punës dhe për mbledhjen e radhës e diskutojmë.

**Mefail Suma thekson:-** është e vërtetë që ndoshta ke mbetur pa punë por a të kujtohet kur kam ardhur te shtëpia dhe kemi biseduar për me shkuar drejtore në Kaçanik.

**Florim Shkreta thekson:-** edhe unë jam sikur t'i por asnijëherë nuk ankohem dhe nuk bëhem si gjynah. Unë kërkojë që konkursi kur të shpallet duhet të favorizohen personat të cilët e meritojnë dhe nuk është ndonjë problem i madh se pse nuk më punëson mua. Unë e kam matur mirë jam në këtë pjesë dhe nuk i hidhërohem kryetarit të komunës se pse nuk më merr në punë dhe ai i cili hidhërohet e ka shumë gabim. Unë kërkoj që personat të cilët e meritojnë që janë nëpër vende kyçe ne të punësohen sepse po vijmë me një situatë shumë të keqe i kemi pesë apo gjashtë mjekë dhe detyrohen me punuar jashtë vendit.

**Mefail Suma thekson:-** pasi që shefi i grupit parlamentarë të LDK-së propozoj me diskutuar për ndonjë mbledhje tjetër e pranojë propozimin e tij dhe për këtë mbledhje e tërheq propozimin.

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka pikën shtesë për propozim vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm të një pjese të parcelës numër 00665-8 dhe pika e dytë e rendit të punës të hiqet nga rendi i punës e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 14 për , 1 abstenim. Në tërësi e hedh në votim rendin e punës, rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin 15 anëtarë të kuvendit të komunës).

#### U MIRATUA RENDI I PUNËS

##### Procedojmë me këtë rend të punës:-

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i plotësim ndryshimit të rregullores për transparencë.
3. Miratimi i propozim vendimit për themelimi e vend gjuetisë së përbashkët në teritorin e komunës së Hanit të Elezit.
4. Informatë mbi mbrojtjen e mjedisit.
5. Miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm të një pjese të parcelës numër 00665-8.
6. Të ndryshme.

##### 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedhë në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin 15 anëtarë të kuvendit të komunës).

#### MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

## 2. Shqyrtimi i plotësim ndryshimit të rregullores për transparencë.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Edon Curri** thekson:- plotësim ndryshimi i rregullores është bërë si rezultat i disa ndryshimeve të Udhëzimit Administrativ për Transparencë. Asociacioni i komunave së bashku me kolegjumin për transparencë i kanë përpiluar plotësim ndryshimet të cilat i keni të bashkangjitura në material. Rregullorja është shqyrtuar në KPF dhe në këtë mbledhje do të votohet për debat publik dhe pastaj miratohet në kuvendin e komunës.

**Mefail Suma** thekson:- transparenca adreson dy çështje të drejtën në institucione publike dhe luftën kundër korrupsionit dhe me sa e di që transparenca është që sa më transparentë të jetë puna dhe lufta është më e madhe ndaj korrupsionit. Obligimet e transparencës, qytetarët kanë të drejtë në dokumente zyrtare dhe institucionet kanë detyrë për të përmbyshur këtë të drejtë. Detyrimi i institucioneve është për të ofruar disa kategori dhe të dhëna pa pasur nevojë për kërkeshë të veçantë nga qytetari. Te çështja e dokumenteve zyrtare qëllimin e kam që nuk është e thënë që vetëm me kërkeshë. Zyra për informim duhet të jetë e kompletuar me personel adekuat të diplomuar i cili duhet t'i njehë rregullat e transparencës dhe te ne nuk e kemi. Rregullorja për transparencë duhet të ofrojë informacion për qasje në dokumentet publike, vebfaqja zyrtare, takimet me kryetarin dhe drejtorët, mbikëqyrjen e punës së kryetarit dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimarrje. Kjo rregullore për transparencë nuk ka paraqitur obligime për kryetarin e komunës dhe as për ekzekutivin e komunës dhe këto duhet të obligohen. Aty ku nuk specifikohen obligimet për kryetarin e komunës dhe ekzekutivin komunal paraqet një ikje të qëllimshme nga përgjegjësia dhe llogaridhënia që rezulton transparencën në nivel të kuvendit të komunës. Menaxhimi i keç me pronën komunale sepse menaxhimi i pronës komunale është transparencë që është një nga të metat dhe ka argumente për këto ku më shumë janë akuzuar kryetari i komunës dhe ekzekutivi për menaxhim të keç të pronës komunale, ky është usurpim i kompetencave të kuvendit komunal. Rregullorja nuk ka program për edukimin e qytetarëve për pjesëmarrjen e tyre në debate. Kryetarit të komunës me këtë rregullore po i lejohet një alibi për tu amnistuar nga kritikat dhe mungesa e transparencës. Vebfaqaja e komunës përmban vetëm informacione protokollare dhe aty postohen vetëm vendime të marra në formën e tyre përfundimtare e që nuk është transparente. Sa është transparente blerja e dy veturave që njëri është i regjistruar me regjistrim zyrtarë, ndërsa tjetri me numra të zakonshëm. Sa janë transparente rekomandimet e auditorëve të jashtëm. Unë konsideroj që transparencë në komunën tonë është e kufizuar dhe realizohet 25 %. Opozita nuk e ka tretmanin dhe hapësirën në transparencë. Nuk përmenden askund edhe trupat ndihmëse të kuvendit të komunës. Askund nuk shohë që kryetari i komunës apo drejtorët që duhet t'i kryejnë këto punë. Më pëlqen propozimi i z.Mehmet Ballazhi që potencon që duhet të përgatitet rregullorja dhe nëse është me udhëzim administrativ nuk keni nevojë me proceduar as në kuvend as në debat publik. Unë kërkoj që të paraqiten edhe objektivat e kryetarit të komunës edhe të ekzekutivit te çështja e transparencës për shkak se askund nuk përmenden. Asnjë herë nuk kam lexuar se çka është debatuar në mbledhje të Bordit të Drejtorëve, për në QKMF, për mbledhjet të cilat i mbajnë drejtorët e shkollave, mirëpo nëse kanë mbajtur transparenca nuk është diçka në rregull. Propozoj që rregullorja të përgatitet mirë dhe nuk është vetëm për me potencuar që ka transparencë, mirëpo unë mendoj që nuk ka transparencë në Han të Elezit. Më herët ka pasur transparencë por është transparencë e buxhetit, kurse te çështja e punësimeve nuk njoftohen personat se kush është punësuar. Asnjëherë nuk e kam parë se kush ka kandiduar dhe se është kjo lista prioritare dhe poenët të cilat i ka vlerësuar komisioni. Nuk janë transparente dhe ndoshta nuk është e drejtë por unë e potencova mendimin tim.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 8 për, 2 kundër (prezent ishin 10 anëtarë të kuvendit të komunës).

**U VOTU RREGULLORJA PËR TRANSPARENCË QË TË PËRCILLET PËR DEBAT PUBLIK**

**3. Miratimi i propozim vendimit për themelimi e vendgjuetisë së përbashkët në teritorin e komunës së Hanit të Elezit.**

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Zaim Bela thekson:-** disa komuna më herët e kanë themeluar vendgjuetinë dhe në bazë të procedurave ligjore duhet të merret vendim prej asamblesë komunale për vazhdimin me procedurat e tjera të tenderimit. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Mefail Suma thekson:-** kërkoj sqarim më në detaje se çka është gjuetia e përbashkët. A vijnë prej komunave të tjera apo vetëm qytetarët e komunës së Hanit të Elezit? Vendin të cilin e keni propozuar si vend gjuetie sa e ka sipërfaqen?

**Zaim Bela thekson:-** në territorin e Hanit të Elezit është shoqata e cila funksionon por nuk është legitime dhe gjueti e përbashkët është gjithë territori i Hanit të Elezit. Sipërfaqja që planifikohet të jetë për vend gjuetie është 5000 hektarë. Të drejtë konkurrimi kanë të drejtë me konkurruar shoqatat e gjuetarëve.

**Akif Shkreta thekson:-** në bazë të shkresës që është përcjellë shihet se është obligim ligjorë dhe duhet ta mbështesim. Konsiderojë se duhet t'i bashkangjitet edhe një rregullore nga niveli komunal nëse përcaktohen kriteret sepse dispozitat janë të qarta.

**Florim Shkreta thekson:-** u potencua se do të del në tender dhe përfituesi tenderit çka do të bënë kur ta fiton tenderin?

**Zaim Bela thekson:-** komuna do t'i zhvillon procedurat e tenderimit dhe shoqatat e gjuetisë do të konkurojnë dhe do të përcaktojnë se çka do të ofrojnë nëse do të janë përfitues të tenderit. Do të varet edhe çmimin që e ofron shoqata.

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 8 për, 2 kundër (prezent ishin 10 anëtarë të kuvendit të komunës).

#### **U MIRATUA PROPOZIMI PËR THEMELIMIN E VENDGJUETISË SË PËRBASHKËT NË TERRITORIN E KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT**

#### **4. Informatë mbi mbrojtjen e mjedisit.**

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Nexhmedin Daci thekson:-** kjo informatë është hartuar nga Agjensioni i Kosovarë i Cilësisë së Mjedisit, raportit vjetorë të kompanisë “Sharrcem” për problematikën mjedisore të vitit 2018. Informatat janë marr nga stacioni i monitorimit të ajrit që është i vendosur te shkolla fillore dhe parametrat ndotës siç janë dyoksi i azotit, dyoksi i sulfurit, monoksidi i karbonit, PM 2.5, PM 10 bënë edhe një vlerësim të cilësisë së ajrit për vitin 2018 dhe krahasimin me vitin 2017. Në informatë janë dhënë normat e cilësisë së ajrit sipas Udhëzimit Administrativ nr.02/2011. Në informatë e keni edhe indeksin e cilësisë së ajrit sipas standardit të Bashkimit Evropian që stacioni i monitorimit është onllajnë dhe qytetarët në çdo kohë munden me pa se si është ndotja e ajrit. Në bazë të dhënavë që i ka publikuar Agjencionin Kosovarë për Mbrojtjen e Cilësisë së mjedisit kemi publikuar që në vitin 2018 cilësia e ajrit ka qenë më e dobët se sa në vitin 2017. Kjo më shumë i atribuohet punimeve të kompanisë “Bektelenka”, kompanisë “Sharrcem” dhe numri i madh i veturave të vjetra. Në krahasim me vitin 2017 të gjitha vlerat kanë qenë të rritura në vitin 2018. PM 10 në vitin 2018 për 148 ka qenë mbi limitet e lejuara ndotja. Në material ua kemi përcjellë edhe reportin nga kompania “Sharrcem”. Ndotja e tokës dhe ujit realisht nuk ka ndryshim në raport me vitin 2017. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Mefail Suma** thekson:- a janë tejkaluar vlerat ekuivalente të cilat i shkaktojnë dëm qytetarëve dhe a ka shkuar dikush në përgjegjësi nëse janë tejkaluar këto vlera?

**Nexhmedin Daci** thekson:- e theksova më lartë dhe shembull e mora PM 10 që 148 ditë ka pasur përqendrim mbi vlerat e lejuara por edhe parametrat tjerë kanë qenë mbi këto vlera të lejuara. Në përgjegjësi nuk ka shkuar askush për shkak se është ditur që në momentin që do të fillon autostrada do të ketë ndotje më shumë por ka përfunduar projekti. Te kompania “Sharrcem” janë të njëjtat vlera dhe nuk ka ndryshime por kanë paralajmëruar se kanë me mbyllur anën veriore dhe jugore të hallës së klinkerit dhe punimet janë duke i zhvilluar dhe në momentin që do të përfundon reduktohen niveli i pluhurit nga kompania “Sharrcem”. Probleme ka retromaterialet që i mbajnë jashtë për shkak se nuk kanë të drejtë me i mbajtur në sipërfaqe të hapura.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- postimet të cilat janë publikuar në vebfaqen e Hanit të Elezit për mbeturinat të cilat janë hedhur rrëth lumi Lepenc a janë ndërmarr masa ndaj tyre?

**Nexhmedin Daci** thekson:- kemi reaguar menjëherë në bashkëpunim me policinë dhe janë gjobitur në bazë të rregullores dhe janë detyruar me i pastruar mbeturinat që i kanë hedhur.

**Teuta Shkreta** thekson:- a ka mundësi me u bërë zgjidhje për problemin e ujërave të zeza në mënyrë që mos të hidhen në lumin Lepenc.

**Akif Shkreta** thekson:- ndotja nga kompania “Bektelenka” ka qenë kaluese dhe jo aq e dëmshme për shëndetin e qytetarëve. A është Hani i Elezit zonë e ndotur apo jo dhe nëse është Hani i Elezit zonë e ndotur është ligji i veçantë që është miratuar në Kuvendin e Kosovës. Nëse jemi zonë e ndotur duhet të jemi përfitues sikur komuna e Obiliqit për shkak se është shpallur si zonë e ndotur. Grimcat që dalin nga kompania “Sharrcem” konsideroj që është e dëmshme për shëndetin e qytetarëve dhe duhet të bëjmë trysni te kompania “Sharrcem” për këtë çështje.

**Florim Shkreta** thekson:- Drejtori i Urbanizmit nuk mund të ndërmerr diçka në këtë drejtim për shkak se e ka dikë mbi te i cili i ka interesat e veta se a ja vlen apo nuk ja vlen, mirëpo ne duhet të bëhem bashkë të gjithë dhe të punojmë në këtë drejtim për shkak se ndotja është katastrofë në Han të Elezit. Unë kam kërkuar që matësit për ndotjen e ambientit i cili është i vendosur te shkolla fillore me ja ndërruar vendin me vendosur me një vend më të përshtatshëm.

**Nexhmedin Daci** thekson:- sa i përket ujërave të zeza krejt regjioni i derdhë në lumin Lepenc , mirëpo vazhdimi shështë fol për një projekt të Bashkimit Evropian për ndërtimin e një impianti për trajtimin e ujërave të zeza por diçka konkrete ende nuk ka për shkak se është një investim shumë i madh. Ligji nuk e përcakton që Hani i Elezit është zonë e ndotur. Matësi për ndotjen e ajrit me ligj parashihet që 500 m me qen larg objektit që e shkakton ndotjen e ajrit

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

##### **5. Miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm të një pjese të parcelës numër 00665-8.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Nexhmedin Daci** thekson:- bëhet fjalë për realizimin e projektit për vendosjen e pllakave përkujtimore për dëshmorët e kombit. Te z.Rahman Loku e kemi parë të arsyeshme që  $90 \text{ m}^2$  në mënyrë që të vendoset pllaka përkujtimore për Gafurr dhe Driton Loku. Me kohë kemi dashur me proceduar por problem kemi pasur me çështjen e pronësisë se ishte në emër tjetër kujt dhe e kemi rregulluar.

**Florim Shkreta** thekson:- a bëhet fjalë për vendosjen e pllakës vetëm në këtë parcelë apo për të gjithë dëshmorët. Propozimin që e ka parashtruar z.Mehmet Ballazhi për vendosjen e shtatores Gafurr Loku a është marr ndonjë iniciativë rreth kësaj?

**Mefail Suma** thekson:- nga kush është propozuar ky propozim vendim?

**Nexhmedin Daci** thekson:- propozim vendimi është bërë nga Drejtoria e Urbanizmit.

**Kryesuesi** thekson:- përgjigjet munden me u dhënë te pikë e rendit të punës të ndryshme. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim, rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin 12 anëtarë të kuvendit të komunës).

#### **U MIRATUA PROPOZIM VENDIM PËR SHPALLJEN ME INTERES TË PËRGJITHSHËM TË NJË PJESE TË PARCELËS ME NUMËR 00665-8**

##### **4. Të ndryshme.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mefail Suma** thekson:- rrugën të cilën e ka dëmtuar kompania “Bektelenka” duhet me rregulluar sepse në atë rrugë lëvizin shumë banorë por më shumë lëvizin banorët fshatit Dimcë. z.Nebih Suma nuk jeton në fshatin Dimcë por ka jetuar në Han të Elezit dhe tash është shpërngulur dhe ka shkuar në Ferizaj, mirëpo i ka pruar afër 150 krerë dele në fshatin Dimcë. Banorët e fshatit Dimcë që kemi kafshë po është problem sepse aty ku kullosoin delet dhe kuajt dy muaj ditë bari nuk rritet. Ne nuk po kemi ku me i kullotur gjedhet dhe a ka ardhur për subvencione apo pse nuk ka shkuar në fshatra ku ka fushë për me i kullotur delet. Fshati Dimcë nuk ka sipërsaqe për me i kullotë 150 krerë dele. Është mirë ta dinë edhe komuna sepse mund të vjen deri te problemi.

**Florim Shkreta** thekson:- kryetari i komunës ka paralajmëruar një protestë për çështje të autostradës. Kërkoj përgjigje me shkrim për te fusha e futbollit se kush është pronarë i asaj parcele kërkoj që t'i bashkëengjitet fleta poseduese dhe kopja e planit. Kërkoj përgjigje me shkrim nga Drejtoria e Financave fletëpagesën e objektit të rrënuar të objektit të z.Sami Brava.

**Akif Shkreta** thekson:- te kufiri po vozitet shumë shpejtë dhe kyçja e qytetarëve në atë pjesë është problematike. Është mirë të vendoset ndonjë semaforë apo të bëhet një trysni në nivelin qendrorë. Pasi është hyrje Kosovës pjesa të kufiri komuna është mirë të parashevë ndonjë projekt afat gjatë në mënyrë që të rregullohet ajo pjesë e hyrjes te kufiri. Kemi disa lokale dhe nuk kanë pamje estetike sepse është hyrja e Kosovës, mirëpo është mirë që të planifikohet nga Komuna dhe të bëhet diçka e mirë në atë pjesë.

**Teuta Shkreta** thekson:- pjesa që është në mesin e fshatit Gorancë dhe Krivenik e cila quhet “Te Pishat” është mirë që t'i kushtohet rëndësi që mos të dhezen zjarre dhe po hedhen mbeturina, mirëpo komuna është mirë me pasur parasysh. Është mirë që komuna me përcaktuar me mbishkrim pjesën që është për dhezje të zjarreve për zgarë.

**Rufki Suma** thekson:- në këtë vit do të ndërtohen lapidare në bazë të projektit të cilin e kemi miratuar në vitin e kaluar. Procedurat e tenderimit janë shpallur dhe me datë 29.08.2019 parashihet të bëhet përrurimi i lapidareve. Sa i përket propozimit që është bërë nga z.Mehmet Ballazhi ka mbetur që vetë shoqatat e dalura nga lufta kur dalin me propozim dhe ne ta shqyrtojmë mundësinë aty ku e kemi pasur plan më herët që të hiqet banesa e të vetmuarve dhe kur të krijohen kushtet vijnë me propozime procedohet për në kuvend për miratim. Për çështjen e nënkalimit apo mbi kalimit ka pasur disa herë protesta dhe ne i kemi përkrahur banorët për me u rregulluar sepse qeveria e ka premtuar dhe nuk e ka realizuar. Ne si komunë kemi paralajmëruar protesta dhe bllokim në ditën e përrimit. Pikërisht reagimin të cilin e kemi bërë ka ndikuar që ministria me nënshkruar marrëveshjen e mirëkuptimit për ndërtimin e mbikalimit të rrugës Dheu i Bardhë Paldenicë por mbetet të diskutohet me banorët kjo çështje. Në marrëveshje shënon edhe rruga e fshatit Dimcë për pjesët të cilat i ka dëmtuar kompania

“Bektelenka” dhe nëse nuk e kryen kompania “Bektelenka” do ta kryen Ministria e Infrastrukturës. Do të rregullohet hyrja e rrugës së fshatit Dermjak deri në pjesën ku kyçet me rrugën te varrezat e reja. Sa i përket bagëtive që u përmendën ne duhet ta inkurajojmë çdo qytetarë i cili del e merret me bujqësi. Edhe më herët kemi pasur kërkesa për kullota dhe kemi potencuar se a jeni ju ata që merreni me bagëti dhe taksën e kemi hequr vetëm e vetëm të kemi qytetarë që merren me bagëti. Emri i z.Nebi Suma që u përmend është banorë i Hanit të Elezit dhe fshatit Dimcë dhe 90 % e politikanëve të Kosovës që e udhëheqin politikën vendbanimet i kanë nëpër vendet e lindjes kurse jetojnë diku tjetër. z.Nebi Suma është banorë i fshatit Dimcë dhe nëse vjen me kërkesë zyrtare nuk i refuzohet por vetëm inkurajohet që të punon. Nuk bëhet fjalë për subvencion se komuna nuk jep subvencion pavarësisht se ku i ka subvencionet i jep Ministria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural. Çështja e pjesës te kufiri çdo herë është përmendur në mbledhje të KKSBS-së që gjithmonë problem kyç është paraqitur hyrja në kufij. Ne kemi bërë kërkesë në qeveri që kemi kërkuar të zgjerohet ajo pjesë në terminal në mënyrë që të bëhet një shirit i rrugës në mënyrë që edhe nëse do të ketë bllokada për shkak të kamionëve që rrinë mos me u bllokuar rruga. Është biseduar varianti i semaforit por mund të jetë problem për banorët se natën mund të ndodhë që nuk ka asnje automjet në kolonë dhe banorët e fshatrave munden me pritur në semaforë. Është menduar forma e rrëthrrrotullimit por ministria ende nuk ka dhënë version sepse është në kompetencë e ministrisë. Qytetarët e ndryshëm që kanë pasur ndonjë mbeturinë të cilën nuk kanë mundur me i djegur dhe në Zhenden kanë mundur me shkuar por duhet të janë në mënyrë të kontrolluar dhe ne nuk mund ta përcaktojmë si komunë për mbeturinat se ku kanë me u djegur. Komuna e ka menduar që me pastruar atë teren. Është mirë që me nxënësit me dal në formë të organizuar dhe pasi që është bërë rruga për në fshatin Neqafçë mund ta shfrytëzojmë. Komuna në të ardhmen do vendosë shenja dhe “Te pishat” nuk duhet të shfrytëzohet për zgarë sepse mund të shkaktohet zjarr.

**Mefail Suma** thekson:- unë e shohë që kryetari nuk ka njohuri rreth bujqësisë dhe e dinë fort mirë sa ka qenë sipërfaqja e më parëshme dhe sa e ka marr çimentorja dhe ka shumë pak ledina. Gjedhet nuk kanë se ku të kullosin dhe nëse edhe ne shkojmë dhe banojmë në Prishtinë dhe vijmë verës e shfrytëzojmë fshatin Dimcë dhe përsëri me u tërheqë atje , mirëpo nëse jeni për me u inkurajuar ka fushë dhe me sa e dijë që fshati Gorancë është një ndër fshatrat më të mëdha në Kosovë dhe ka sipërfaqe më të madhe në Han të Elezit. Nuk di si mendoni me inkurajuar një person kur nuk ka me i sjell delet dhe pronë të veten nuk ka sepse e ka shitur. Unë e di që personi në fjalë është i fshatit Dimcë por duhet me menduar edhe për ne të tjerët se çka të bëjmë. Ne po i hekim gjedhet të gjithë dhe atëherë atë inkurajone ne ti mbanë delet dhe dimrit shkon dhe verës vjen.

**Florim Shkreta** thekson:- marrëveshjen komuna që e ka bërë me kompaninë “Bektelenka” dhe nuk e di për cilën pjesë kanë biseduar se për këtë pjesën nën breg shumë qytetarë janë ankuar dhe nuk kanë qenë të kënaqur me punën që e ka bërë kompania “Bektelenka” sepse nuk i ka kryer punimet siç duhet.

**Rufki Suma** thekson:- çështjen e kontratave private qytetarët që i kanë pasur qytetarët me kompaninë “Bektelenka” është çështje tyre sepse nuk kanë ditur me shfrytëzuar mirë sepse kanë mundur me kërkuar dhe më të mirë. Edhe nëse nuk ju kanë përmbajtur kontratave kanë të drejtë me paditur në gjyq kompaninë. Qytetarët nëse janë ankuar në komunë ne i kemi bërë presion dhe problemet që i kemi pas me pronat publike ne kemi kërkuar. Të gjitha fshatrat e tonë më herët kanë pasur edhe dhjetë herë më shumë se sot bagëti dhe nëse dikujt i shkakton problem me ndonjë pronë private qytetari ka drejtë me ndalë, kurse pronat publike janë të lira për kullotë për të gjithë dhe askush nuk ka drejtë me i ndalë.

**Mefail Suma** thekson:- para 50 viteve ka pasur ledina por ato ledina janë bërë male tash, mirëpo ne do të jetojmë dhe nuk do të ikim prej fshatit Dimcë për shkak të z.Nebi Suma por ai ka ikur. Para një muaje i kam parë dy vutura dhe njëra ishte me regjistrim zyrtarë dhe njëra me regjistrim të zakonshëm. Kërkoj sqarim.

**Florim Shkreta** thekson:- është e vërtetë që nuk mundet me ndërhyjë te ata persona të cilët kanë bërë kontrata por problemi është çështja e jazit të cilin e ka dëmtuar kompania “Bektelenka” dhe ka premtuar se do ta rregullon por nuk e ka rregulluar.

**Rufki Suma** thekson:-zyrtarisht është e drejtë e secilit person nëse e ka nënshkruar një kontratë dhe nuk ju ka permblajtur me vazhduar përmes gjykatës. Çështja e veturave është e drejtë e kryetarit të komunës që me pas edhe automjet civil dhe me targa zyrtare dhe na e kanë mundësuar me regjistruar.

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen e kuvendit të komunës. Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:29

**Procesmbajtësi**

Ayni Bushi



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**MSc. Qamush Brava**

